



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3383/Prot.
12

Shijak, më 18.06.2026

Lënda: Kërkesë për publikim vendesh të lira

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT
Tiranë


Bashkia Shijak, ka vendosur të shpallë procedurën e konkurimit për grupin e pozicioneve të shpallura për konkurim, "Lloji i diplomës "Ekonomi / Juridik "

Për këtë arsye, në përputhje me Ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. dhe aktet nënligjore dalë në bazë e në zbatim të tij, kërkojmë publikimin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit".

Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën përkatëse për publikim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Elton Arbana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3303 Prot.

Shijak, më 18.06.2026

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës “Ekonomi / Juridik” niveli minimal i diplomës
“Bachelor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Shijak shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- 1 Specialist (për taksat)

në Drejtorinë e Taksave , Tarifave dhe Kadastrës Fiskale , Kategoria e pagës IV-3.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës se pranimit në shërbimin civil.

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 29.06.2026	Lëvizje paralele
Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 06.07.2026	Pranim në shërbimin civil

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Është përgjegjës për hartimin e dosjeve për çdo subjekt në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Bashkëpunon e bashkërendon punën me specialistët e sektorëve të tjerë në lidhje me shtimin e informacionit për çdo subjekt;

Nxjerr faturat e taksave dhe tarifave për çdo subjekt;

Ndjek ecurinë e likuidimit të detyrimeve nga subjektet dhe indentifikon subjektet debitore;

Evidenton problemet të cilat vinë nga verifikimi dhe ndjekja në terren e debitorëve dhe jep një informacion pranë shefit të sektorit për këtë çështje;

Jep informacion ditor pranë Drejtorit të Drejtorise mbi gjendjen dhe numrin e debitorëve që i janë caktuar për ndjekje;

Njofton subjektet debitore që i janë caktuar, për masën e detyrimit dhe ndjek ecurinë e tij me të gjitha format që parashikon ligji për procedurat tatimore;

Përpilon listën e subjekteve debitore të zonës që ka në ngarkim, e cila i kalon për informacion Degës së Tatim Taksave;

Nxjerr faturat dhe njoftimet për taksat e popullatës si dhe ndjek arketimet duke i rakorduar me Drejtorinë e Finances

I-LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori IV-3 .
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv ;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor", në Ekonomi/Juridik.

Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.

b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.

c) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b) <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i) Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 29.06.2026.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 01.07.2026 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar .
- d) Njohuritë mbi Kodin e Proçedurave Administrative
- e) Legjislacioni në fushën e taksave dhe tatimeve

Adresa: Lagja “Erzen” Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

1.6**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Shijak do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nepunesit civil", i ndryshuar.

2.1**KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al

- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në degën Ekonomi/Juridik.
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- b) <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c) Fotokopje të diplomës;
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i) Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 06.07.2026 , në Institucionin Bashkia Shijak.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 08.07.2026 , njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Shijak , ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar .
- d) Njohuritë mbi Kodin e Proçedurave Administrative
- e) Legjislacioni në fushën e taksave dhe tatimeve

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:


- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Adresa: Lagja “Erzen” Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Shijak do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

KRYETARI
Elton Arbana



REPUBLIC OF ALBANIA
BASHKIA SHIJAK

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: www.shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al